



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 4/17 Prot.

Tiranë, më 30.05.2024

VENDIM

Nr. 12, Datë 30.05 /2024

“PËR NGRITJEN E QENDRAVE TË VOTIMIT
NË FAKULTETIN E MJEKËSISË
TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në nenin 6, pika 3, shkronja “e” të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2024, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UMT, i mbledhur sot më datë 30.05.2024,

VENDOSI:

1. Ngritjen e 3 (tre) qendrave të votimit, në Fakultetin e Mjekësisë të UMT-së.
2. Vendimi dërgohet për zbatim në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Mjekësisë, të UMT-së.
3. Ky Vendim të publikohet në mjedise të dukshme të Fakultetit, në faqen e tij zyrtare dhe në faqen zyrtare të UMT-së.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



Adela Perolla

Edlira Kruci

Daniela Tasha

Fatmir Lela

Gentjan Asllanaj

Arnold Rrushi